



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 25 Prill 2021

Nr: 300

V E N D I M

**PËR PLOTËSIMIN E SASISË SË FLETËVE TË VOTIMIT TË QV-SË SË POSACME
IEVP, TË ZAZ NR.90, QARKU VLORË**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronja “n”, dhe paragrafi 2, nenin neni 97, paragrafi 4, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V Ë R E N

KZAZ nr.90, qarku Vlorë, njofton se në ambientet e QV së posacme në paraburgim IEVP, mungojnë 4 fletë votimi për shkak se janë shtuar personat për të votuar me vërtetim gjykate, e cila nuk ishte parashikuar.

Për sa më sipër KQZ duhet të marrë të gjitha masat për të siguruar të drejtën e votës të zgjedhësve të QV së posacme IEVP. Në këto kushte, KQZ duhet të autorizojë KZAZ nr.90 që të marrë masat për të siguruar fletët e votimit e kësaj QV-je nga qendrat e tjera të votimit të ZAZ-së nr.90, dhe për ti dërguar në qendrën e votimit të posacme në paraburgim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja“ç”, dhe 2, nenet 30, 31, dhe 32, paragrafi 2, shkronja “d”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSA:

1. Të autorizojë KZAZ-në Nr.90, qarku Vlorë, që me vendim të marrë 4 fletë votimi nga QV-ja nr. 4667 dhe t'i dorëzojë në QV-në e posacme IEVP, Sarandë. Në total do të merren 4 fletë votimi për të pajisur këtë QV.
2. KZAZ nr.90, të marrë masat që QV e posacme IEVP, Sarandë të pajiset brenda orës 12:30, të datës 25.04.2021, me fletët e votimit nga QV-ja e ZAZ-së që administron.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet ne faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Illirjan CELIBASHI

